



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 dhjetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Urdhrit të 21 Nëntorit 2025

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe të rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 nëntor 2025, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër ku kërkonte parashtrime nga palët dhe pjesëmarrësit në lidhje me modalitetet për zhvillimin e procesit të zhdëmtimit ("Urdhri i 6 Nëntorit 2025").¹

2. Më 17 nëntor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), ekipet e Mbrojtjes dhe Mbrojtja e Viktimave dorëzuan parashtrimet përkatëse të tyre në lidhje me Urdhrin e 6 Nëntorit 2025.² Në përgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes, Mbrojtja paraqiti parashtrime shtesë lidhur me procedurën e veçantë të përcaktimit të dënimit ("Përgjigja e Mbrojtjes e 17 Nëntorit 2025").³

3. Më 19 nëntor 2025, Trupi Gjykues mbajti një konferencë mbi ecurinë e çështjes në lidhje me aspekte të administrimit të gjykimit ("Konferenca mbi Ecurinë e Çështjes").⁴ Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes, Trupi Gjykues dëgjoi parashtrime nga palët dhe pjesëmarrësit në lidhje me, ndër të tjera, kërkesën e Mbrojtjes për një procedurë të veçantë për përcaktimin e dënimit.⁵

¹ F03565, Trupi Gjykues, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit* ("Urdhri i 6 Nëntorit 2025") 6 nëntor 2025, konfidencial.

² F03582, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, 17 nëntor 2025, konfidencial; F03583, Mbrojtja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtjes së Viktimave në Përgjigje ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit* (F03565), 17 nëntor 2025, konfidencial; F03584, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Procesin e Zhdëmtimit*, 17 nëntor 2025, konfidenciale.

³ Përgjigja e Mbrojtjes e 17 nëntorit 2025, para. 12-17.

⁴ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28307-28356.

⁵ Transkripti i seancës, 19 nëntor 2025, f. 28353, rreshti 20 deri në f. 28355, rreshti 18.

4. Më 21 nëntor 2025, pas konferencës mbi ecurinë e çështjes, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër përmes të cilit, ndër të tjera, rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për një procedurë të veçantë për përcaktimin e dënimit dhe urdhëroi palët të bënin parashtrime, nëse kishin, në lidhje me përcaktimin e dënimit në dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre (“Urdhri i Kundërshtuar”).⁶
5. Më 1 dhjetor 2025, Mbrojtja dorëzoi kërkesën e përbashkët për leje për apelimin e Urdhrit të Kundërshtuar (“Kërkesa”).⁷
6. Më 12 dhjetor 2025, ZPS-ja u përgjigj (“Përgjigjja”).⁸
7. Më 17 dhjetor 2025, Mbrojtja u kundërpërgjigj (“Kundërpërgjigjja”).⁹

II. PARASHTRIMET

8. Mbrojtja kërkon leje për apelimin e Urdhrit të Kundërshtuar në lidhje me dy pika (bashkërisht, “Pikat”):
 - i. Nëse Trupi Gjykses nuk dha arsye të mjaftueshme për rrëzimin e kërkesës së Mbrojtjes për zbatimin e procedurës së veçantë për përcaktimin e dënimit siç përcaktohet në rregullat 162 dhe 164 të rregullores (“Pika e Parë”); dhe
 - ii. Nëse zbatimi i procedurës për përcaktimin e dënimit sipas rregullës 159(6) të Rregullores nga Trupi Gjykses shkeli të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë (“Pika e Dytë”).¹⁰

⁶ F03597, Trupi Gjykses, *Urdhër sipas Rregullave 134(b), (d) dhe 159(6) dhe Çështje lidhur me To*, 21 nëntor 2025, para. 35-38, 39(h).

⁷ F03605, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Urdhrit të 21 Nëntorit*, 1 dhjetor 2025.

⁸ F03625, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Parashtrimit (F03512)*, 12 dhjetor 2025.

⁹ F03625, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit të 21 Nëntorit 2025*, 17 dhjetor 2025; CRSPD954, *Mesazh elektronik i Trupit Gjykses drejtuar Ekipeve të Mbrojtjes në lidhje me Kundërpërgjigjen ndaj F03625*, 15 dhjetor 2025, konfidencial.

¹⁰ Kërkesa, para. 2.

9. Mbrojtja parashtron se Kërkesa duhet të miratohet.¹¹ Mbrojtja e Thaçit argumenton se: (i) pikat janë të apelueshme;¹² (ii) pikat ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;¹³ dhe (iii) vendimi mbi to nga Paneli i Gjykatës së Apelit ("Paneli i Apelit") do ta avanconte thelbësisht procesin gjyqësor.¹⁴

10. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet pasi asnjëra pikë nuk përmbush kriteret e dhënies së lejes për apel.¹⁵ ZPS-ja argumenton se pikat e ngritura në Kërkesë nuk janë pika të apelueshme¹⁶ dhe Mbrojtja nuk tregon se rishqyrtimi i ndërmjetëm i apelit do të ketë ndonjë ndikim mbi zhvillimin e procesit.¹⁷

11. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja i qëndron argumentit të vet se pikat janë të apelueshme¹⁸ pasi: (i) Trupi Gjyqësor nuk u përfshi në asnjë kuptim në themelësinë e parashtrimeve të Mbrojtjes në Përgjigjen e Mbrojtjes të 17 nëntorit 2025;¹⁹ dhe (ii) Trupi Gjyqësor nuk mori parasysh parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me kompleksitetet e kësaj çështje.²⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një aspekt që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes

¹¹ Kërkesa, para. 29; Kundërpërgjigjja, para. 6.

¹² Kërkesa, para. 14, 23; Kundërpërgjigjja, para. 2, 4.

¹³ Kërkesa, para. 24-26; Kundërpërgjigjja, para. 5.

¹⁴ Kërkesa, para. 27.

¹⁵ Përgjigjja, para. 1, 12, 13.

¹⁶ Përgjigjja, para. 1. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 2-8.

¹⁷ Përgjigjja, para. 1. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 9-12.

¹⁸ Kundërpërgjigjja para. 2-4.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 2.

²⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3.

së çështjes që gjykohet dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

13. Trupi Gjykues përfshin përmes referencave dispozitat ligjore mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, sikurse është përcaktuar në vendime të mëparshme.²¹

IV. DISKUTIM

14. Në Urdhrin e Kundërshtuar, pasi shqyrtoi argumentet e Palëve, Trupi Gjykues vendosi se rrethanat e çështjes aktuale nuk përlligjin shmangien nga prezumimi i përcaktuar në rregullën 159(6) dhe rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për një procedurë të veçantë të përcaktimit të dënimit.²² Mbi këtë bazë, Trupi Gjykues urdhëroi palët të dorëzonin parashtrime, nëse dëshironin, në lidhje me përcaktimin e dënimit në dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre.²³ Kur e mori këtë vendim, Trupi Gjykues mori parasysh se: (i) rregulla 159(6) parasheh një procedurë të veçantë të përcaktimit të vendimit vetëm si opsion të dytë (“përveçse pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues vendos të procedojë në përputhje me rregullën 162 dhe rregullën 164”);²⁴ (ii) ekziston prezumimi se Trupi Gjykues përcakton dënimin e duhur njëkohësisht me shpalljen e aktgjykimit;²⁵ dhe (iii) në përmbushjen rigoroze të përgjegjësisive të tyre, Mbrojtja dhe palët duhet të kenë përgatitur dhe paraqitur në gjykim të gjitha provat që sipas tyre janë relevante për përcaktimin e dënimit.²⁶

²¹ *Shih p.sh.* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8, që i referohen KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. *Shih gjithashtu* F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

²² Urdhri i Kundërshtuar, para. 35-39(h).

²³ Urdhri i Kundërshtuar, para. 38, 39.

²⁴ Urdhri i Kundërshtuar, para. 37.

²⁵ Urdhri i Kundërshtuar, para. 37.

²⁶ Urdhri i Kundërshtuar, para. 37.

A. PIKA E PARË

15. Mbrojtja argumenton se Pika e Parë nuk është një pikë për të cilën ka thjesht mospajtim, pasi Trupi Gjykes nuk dha asnjë arsye për të arsyetuar vendimin e tij.²⁷ Në veçanti, Mbrojtja pretendon se Trupi Gjykes nuk bëri asnjë përpjekje për të shqyrtuar themelësinë e kërkesës së Mbrojtjes për një procedurë të veçantë për përcaktimin e dënimit, pavarësisht se ishte i detyruar ta bënte këtë sipas rregullës 159(6). Mbrojtja pretendon se, kur rrëzoi kërkesën për një procedurë të veçantë për përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykes e kishte për detyrë të shpjegonte saktësisht pse një procedurë e tillë ishte e papërshtatshme në çështjen aktuale.²⁸ Në këtë aspekt, Mbrojtja parashton se Trupi Gjykes nuk dha asnjë citim, diskutim apo shpjegim pse argumentet e Mbrojtjes nuk qëndronin, dhe as nuk shpjegoi se si rrethanat në çështje të tjera të gjykuara para Dhomave të Specializuara ("DHS") ishin në ndonjë mënyrë të krahasueshme me çështjen aktuale, në mënyrë të tillë që të përlligjinin procedurën e integruar të përcaktimit të dënimit.²⁹

16. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë bazohet në keqinterpretimin e Urdhrit të Kontestuar dhe nuk është e apelueshme.³⁰ ZPS-ja parashton se, duke pasur parasysh llojin e parashtimeve të bëra në Përgjigjen e Mbrojtjes të 17 Nëntorit 2025, të cilat kundërshtonin kornizën ligjore të përcaktuar në Rregullore dhe shprehnin mospajtim të përgjithshëm me të, Urdhri i Kundërshtuar i trajtoi ato në mënyrë të përshtatshme duke konstatuar se nuk gjykonte që Mbrojtja kishte demonstruar se rrethanat e çështjes aktuale përlligjinin shmangien nga prezumimi i përcaktuar në rregullën 159(6).³¹

²⁷ Kërkesa, para. 14.

²⁸ Kërkesa, para. 12.

²⁹ Kërkesa, para. 13.

³⁰ Kërkesa, para. 2, 4.

³¹ Përgjigja, para. 3.

17. Mbrojtja kundërpërgjigjet se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, Trupi Gjykses nuk dha ndonjë arsytim në mbështetje të konstatimeve të veta për aspekte materiale në lidhje me procedurën e veçantë të përcaktimit të dënimit.³²

18. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren dhe rithekson se rregulla 159(6) përcakton parimin se aspektet e themelësisë dhe përcaktimit të dënimit të një çështjeje duhet të trajtohen së bashku.³³ Sipas asaj dispozite, procedura e veçantë e përcaktimit të dënimit përbën përjashtim sipas rregullave 162 dhe 164. Kërkesa nuk duket se e pranon këtë hierarki normative. Në këtë kuptim, Kërkesa duket se pasqyron mospajtimin e Mbrojtjes jo vetëm me Urdhrin e Kundërshtuar, por edhe me Rregulloren.

19. Së dyti, duke ndjekur procedurën sipas Rregullores, Trupi Gjykses konsideroi parashtrimet e Mbrojtjes të bëra në Përgjigjen e Mbrojtjes të 17 Nëntorit 2025 dhe gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes; kjo ilustron nga fakti se Trupi Gjykses iu referua atyre konkretisht në Urdhrin e Kundërshtuar.³⁴ Mbrojtja nuk jep asnjë argument për kundërshtimin e saj se rregulla 159(6) i kërkon Trupit Gjykses të japë argumente të hollësishme kur rrëzon kërkesën për procedurë të veçantë për përcaktimin e dënimit.

20. Sa i takon argumenteve të Mbrojtjes se Urdhrit të Kundërshtuar i mungon çdo arsytim bazë, Trupi Gjykses vëren se për të përmbushur detyrimin e vet për të dhënë një opinion të arsyetuar, nuk është e nevojshme që të trajtohen të gjitha argumentet e palëve, për sa kohë ai tregon me qartësi të mjaftueshme arsytet mbi të cilat e mbështet vendimin e vet.³⁵ Trupi Gjykses vëren se, në Urdhrin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses gjykoi se rrethanat e kësaj çështjeje nuk përlligjin

³² Kundërpërgjigjja, para. 2.

³³ *Shih* Urdhrin e Kundërshtuar, para. 37, poshtëshënimi 60.

³⁴ Urdhri i Kundërshtuar, para. 35, poshtëshënimi 54-58.

³⁵ *Shih, p.sh.*, KSC-BC-2023-12, IA008/F00006/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 5 dhjetor 2025, publik, para. 16. *Shih gjithashtu*, KSC-CA-2024-03, F00069/RED, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit*, 14 korrik 2025, para. 43.

shmangie nga prezumimi i përcaktuar në rregullën 159(6).³⁶ Siç është vënë re tashmë, Trupi Gjykes vlerëson se qëndrimi kryesor i çdo vendimi mbi procedurën e zbatueshme të përcaktimit të vendimit është ai që përshkruhet në rregullën 159(6), përkatësisht që, në qoftë se i akuzuari shpallet fajtor për një ose më shumë vepra penale, trupi gjykes përcakton dënimin e duhur për të akuzuarin që shqiptohet në aktgjykim, përveç nëse vendoset ndryshe,³⁷ dhe në mbështetje, Trupi Gjykes citoi vendimin e Trupit Gjykes në KSC-BC-2020-07 si një burim ligjor tjetër.³⁸ Bazuar në sa më lart, është e qartë se Trupi Gjykes shqyrtoi preferencën normative të Rregullores si dhe rrethanat konkrete të kësaj çështjeje për të arritur në përfundimin e tij.

21. Ndërsa Trupi Gjykes nuk trajtoi çdo argument të ngritur nga Mbrojtja në analizën e tij, Trupi Gjykes i mori ato të gjitha parasysh dhe iu referua shprehimisht parashtrimeve thelbësore të Mbrojtjes se: (i) procedura e veçantë e përcaktimit të dënimit është në përputhje me të drejtën e të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe është në interes të ekonomisë gjyqësore; (ii) të akuzuarit duhet të kenë të drejtë të bëjnë parashtrime specifike, konkrete lidhur me përcaktimin e dënimit pas marrjes për çdo dënim fajësie, pasi përndryshe parashtrime të tilla do të bëheshin në zbrazëti; (iii) të akuzuarit nuk mund të bëjnë parashtrime të përnjëmendta lidhur me peshën e pretendimeve të ngritura pa një vendim të Trupit Gjykes lidhur me faktet dhe krimet e provuara; dhe Mbrojtja ka të drejtën të paraqesë prova relevante për përcaktimin e dënimit dhe asaj duhet t'i jepet kohë dhe mundësi për ta bërë këtë.³⁹

22. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me rezultatin e vendimit të Trupit Gjykes në Vendimin e Kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, Pika e Parë nuk përmbush kriterin e parë të

³⁶ Urdhri i Kundërshtuar, para. 38.

³⁷ *Shih më lart*, para. 18. *Shih gjithashtu* Urdhrin e Kundërshtuar, para. 37.

³⁸ Urdhri i Kundërshtuar, para. 37, poshtëshënimi 60 dhe referencat në të.

³⁹ Urdhri i Kundërshtuar, para. 35.

rregullës 77(2). Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me Pikën e Parë. Rrjedhimisht, kërkesa për leje për apelimin e Pikës së Parë rrëzohet.

B. PIKA E DYTË

23. Mbrojtja parashton se Trupi Gjykses nuk mori parasysh rrethanat unike të çështjes aktuale kur vendosi lidhur me modalitetet e procedurës së përcaktimit të dënimit, të cilat, sipas pikëpamjes së Mbrojtjes, përlijin një procedurë të veçantë të përcaktimit të dënimit.⁴⁰ Mbrojtja argumenton se kjo çështje nuk është e krahasueshme me çështje të tjera para DHS-së.⁴¹ Mbrojtja parashton më tej se domosdoshmëria e një procedure të veçantë të përcaktimit të dënimit në çështje komplekse që përfshijnë forma alternative dhe të ndryshme të përgjegjësisë është një praktikë ndërkombëtare penale të konsoliduar.⁴² Mbrojtja gjithashtu parashton se, duke refuzuar miratimin e një procedure të veçantë të përcaktimit të dënimit, Urdhri i Kundërshtuar i detyron të akuzuarit të përfshihen në spekulime paragjyqese, gjë e cila, sipas Mbrojtjes bie ndesh me të drejtën e të akuzuarve për dorëzimin e parashtrimeve të njëmendta dhe përgatitjen e mbrojtjes bazuar në këto konstatime.⁴³ Ngjashëm, Mbrojtja parashton se në një çështje komplekse si në rastin e kësaj çështje, procedura e veçantë e përcaktimit të dënimit është mënyra e vetme e drejtë dhe e arsyeshme e veprimit dhe është e nevojshme për të garantuar të drejtat e të akuzuarve për të pasur kohë dhe mjete të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre.⁴⁴

⁴⁰ *Shih* Kërkesën, para. 16, 19.

⁴¹ Kërkesa, para. 16, 18, 20.

⁴² Kërkesa, para. 17, 18.

⁴³ Kërkesa, para. 19.

⁴⁴ Kërkesa, para. 22.

24. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me Urdhrin e Kundërshtuar dhe nuk vërteton se Pika e Dytë është e apelueshme.⁴⁵ ZPS-ja gjithashtu përgjigjet se parashtrimet e bëra nga Mbrojtja në lidhje me Pikën e Dytë shtrembërojnë Urdhrin e Kundërshtuar dhe kornizën ligjore të zbatueshme.⁴⁶ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se brenda kornizës ligjore të DHS-së, procedura e prezumuar është që Trupi Gjykses përcakton dënimin e duhur në të njëjtën kohë kur shqipton aktgjykimin, dhe përderisa Mbrojtja nuk e bindi Trupin Gjykses se pse nuk duhet të zbatohet kjo procedurë e prezumuar në çështjen aktuale, pretendimi i saj se Urdhri i Kundërshtuar është i padrejtë dhe i paarsyeshëm është çorientues dhe i pabazë.⁴⁷

25. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Kërkesa e saj nuk është e pabazë pasi Trupi Gjykses nuk shqyrtoi parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me kompleksitetet e kësaj çështje.⁴⁸ Mbrojtja gjithashtu përgjigjet se Trupi Gjykses gaboi kur vendosi për të njëjtën procedurë për përcaktimin e dënimit për çështjen aktuale pa marrë parasysh parimet e renditura në jurisprudencë në lidhje me çështje me kompleksitet të ngjashëm, ose të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë.⁴⁹

26. Trupi Gjykses vëren se thelbi i argumentit të Mbrojtjes përqendrohet në pretendimin se Trupi Gjykses nuk mori parasysh kompleksitetet e çështjes aktuale kur rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për një procedurë të veçantë të përcaktimit të dënimit. Siç u vu në dukje në lidhje me Pikën e Parë, është e qatë nga leximi i Urdhrit të Kundërshtuar se, kur vendosi lidhur me procedurën e duhur të përcaktimit të dënimit, Trupi Gjykses shqyrtoi parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me kompleksitetet e kësaj çështje, të drejtat e të akuzuarve, dhe mundësinë e Mbrojtjes për të bërë parashtrime të duhura lidhur me përcaktimin e dënimit.⁵⁰ Gjithashtu,

⁴⁵ Përgjigjja, para. 6, 8.

⁴⁶ Përgjigjja, para. 5, 7.

⁴⁷ Përgjigjja, para. 7.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja, para. 3.

⁴⁹ Kundërpërgjigjja, para. 4.

⁵⁰ Urdhri i Kundërshtuar, para. 35. *Shih gjithashtu* më lart, para. 21.

është e qartë nga Urdhri i Kundërshtuar se Trupi Gjykses i formoi pikëpamjet e veta bazuar në “praktikën e kësaj gjykate”.⁵¹ Siç u deklarua në lidhje me Pikën e Parë,⁵² Trupi Gjykses e bazoi vendimin e vet në preferencën e tij për të ndjekur hierarkinë normative të përcaktuar në Rregullore. Trupi Gjykses nuk e kupton se si ai ishte i detyruar të merrte parasysh çështje të tjera komplekse të juridiksioneve të tjera, siç sugjerohet nga Mbrojtja.⁵³ Pasi shqyrtoi të gjithë faktorët relevantë, Trupi Gjykses gjykoi se rrethanat në çështjen aktuale nuk përlligjinin shmangien nga prezumimi i rregullës 159(6).⁵⁴ Gjithashtu, ndërsa Trupi Gjykses nuk renditi shprehimisht të gjitha kompleksitetet e kësaj çështjeje në pjesët relevante të Vendimit të Kundërshtuar, në shumë pjesë të tjera të Vendimit të Kundërshtuar bëhet e qartë se Trupi Gjykses në fakt është udhëzuar nga parashtrimet e palëve lidhur me specifikat e kësaj çështjeje.⁵⁵ Rrjedhimisht, sugjerimi se Trupi Gjykses nuk mori parasysh rrethanat specifike të kësaj çështjeje, ose anashkaloi parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me këtë aspekt, është pa themel.

27. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja rithekson se miratimi i procedurës sipas rregullës 159(6) është i pavend në çështjen aktuale. Trupi Gjykses deklaroi në Urdhrin e Kundërshtuar se rregulla 159(6) parasheh procedurë të veçantë të përcaktimit të dënimit vetëm si opsion të dytë dhe se prezumimi që ekziston është se Trupi Gjykses e përcakton dënimin e duhur në të njëjtën kohë kur shqiptohet aktgjykimi. Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me ushtrimin nga Trupi Gjykses të diskrecionit të vet në Urdhrin e Kundërshtuar për të miratuar procedurën e veçantë të përcaktimit të dënimit pavarësisht parashtrimeve të Mbrojtjes për të kundërtën.

⁵¹ Urdhri i Kundërshtuar, para. 38.

⁵² Shih më lart, para. 18, 20.

⁵³ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 4.

⁵⁴ Urdhri i Kundërshtuar, para. 38.

⁵⁵ *Shih p.sh.* Urdhrin e Kundërshtuar, para. 24, 27, 28, 30, 31, 33, 34.

28. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se Pika e Dytë nuk është e apelueshme. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me Pikën e Dytë.

V. VENDIM

29. Për këto arsye, Trupi Gjykses **RRËZON** Kërkesën për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.

/nënshkrim/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 17 dhjetor 2025

Në Hagë, Holandë.